



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pratima - Përmirësimi të Dama 27.12.2024			
Nr. i Propozimit Org. Ibra	Nr. i Propozimit	Titulli i Propozimit	Vlera Vendimost
01-110/05-1498			



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d, nenit 40, nenit 51 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008, nenit 36. paragrafi 36.2 shkronja d, lidhur me nenin 44 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/49, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 26.12.2024, miraton këtë:

## V E N D I M

### për aprovimin e planit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2025

#### Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton planin e punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2025, për Komunën e Vitisë.

#### Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Planin i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025 për Komunën e Vitisë me Nr. 02-052/01-1455, i datës 17.12.2024.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi dhe planin e punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2025 për Komunën e Vitisë do të kujdeset Kryesuesi i Kuvendit dhe kryesuesi i Komitetit për Komunitete.

#### Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit;
2. Kryesuesit të Komitetit për Komunitete; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË  
KRYESUESI

Bekim Azizi

